

**AKT – THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**" IRED.AL " SHPK**

Sot me daten 03/02/2020 (dymijë e njëzet ), unë ortaku themelues :

- **I Z.Rihat Doçi**, I biri i Shpetim, shtetas Shqiptar, i datëlindjes 08 Gusht 1988, lindur në Durrës dhe banues në Lagjen nr 6, ,Durrës, person madhor e me zotësi të plotë për të vepruar, disponues i Leternjoftimit (pasaportë) me Nr. Nr.personal I80808116D.

Në përputhje me Ligjin nr.9901 Datë 14.04.2008, si edhe Ligjin nr.9723 datë 3.5.2007, nenet 26,28,32 e 35 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ",

Kam vendosur të themeloj *Shoqerinë me Pergjegjësi të Kufizuar "IRED.AL" SHPK*.

**NENI 1.**  
**EMËRTIMI I SHOQËRISË**

Shoqëria do të quhet "IRED.AL" SHPK.

**NENI 2**  
**SELIA E SHOQËRISË**

Shoqëria do të ketë selinë e saj në, " Lagja nr 18, Rruga Aleskander Goga, ,Durrës, zona kadastrale 8513, nr pasurie 1/152+2-3,volum 18, faqe 39, apartament, kati i parë."

**NENI 3**

**OBJEKTI I VEPRIMTARISË SË SHOQËRISË**

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj ne fushen e:

- Tregëti të të gjitha llojeve të materialeve elektrike, elektronike, hidraulike, telekomunikacioni,kompjuterike, kamera sigurie, pajisje alarmi.
- Shërbime kompjuterike, elektike, elektronike,hidraulike, telekomunikacioni, kompjuterike, , kamera sigurie, pajisje alarmi.
- Eksport-import të të gjitha llojeve të materialeve elektrike, elektronike, hidraulike, telekomunikacioni,kompjuterike, kamera sigurie, pajisje alarmi.

**NENI 4**

## KAPITALI THEMELTAR I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë "**IRED.AL**" **SHPK** është 100.000 (njëqind mijë) lekë. Ky kapital është i ndarë në 1 kuotë, me vlerë nominale 100.000 (njëqind mijë) lekë.

Kontributi i ortakeve eshte i ndare si vijon:

**1.Rihat Doçi, zotëron 1 kuotë baraz me 100 % të kapitalit.**

## **NENI 5**

### KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Shoqëria do të zhvillojë veprimtarinë e saj për një periudhe kohe të pacaktuar.

## **NENI 6**

### ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Administrator i shoqërisë do të jetë **Z.Rihat Doçi**, i cili emërohet për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

Administratori emërohet dhe shkarkohet me vendim të ortakëve, që përfaqesojnë me tepër se gjysmen e pjesëve të kapitalit themeltar.

Administratori ka të gjithë kompetencat për të vepruar në marredhënie me të tretë në emër të shoqërisë, me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep ortakëve.

Administratori mund të kryejë të gjitha veprimet e administrimit në interes të shoqërisë.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë ose të tretëve për shkelje të ligjeve, statutit apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

## **NENI 7**

### ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME E ORTAKËVE

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të ligjit "Per Shoqerite Tregtare".

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit të përmendorur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

## **NENI 8**

### NDARJA E FITIMEVE

Fitimi që do të shpërndahet përbëhet nga fitimi i vitit financiar, të cilit i janë zbritur shumat e lëna mënjanë për rezervën, si dhe duke i shtuar apo zbritur fitimet ose humbjet e mbartura nga vitet e mëparshme.

*Neni 9*  
**LIKUIDIMI**

Shoqëria është në likuidim e sipër që në momentin e prishjes së saj , operacion i cili do të kryhet sipas kërkesave të parashikuara në legjislacionin tregtar shqipëtar.

***NENI 10***  
**MOSMARRËVESHJET**

Mosmarrëveshjet zgjidhen me mirëkuptim.Në rast të kundërt, ortakët themelues do ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Durrës për zgjidhje.

***ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË  
"IREDA" SH.P.K***

***RIHAT DOÇI***

*Rihat Doçi*

